

*Tri esetë më të mira të konkursit të eseve me temë*

## **“TË RINJTË I THONË JO KORRUPSIONIT”**

**Nga Albion Bylykbashi**

Zhvillimi është dhe do të jetë padyshim aspirata instiktive e çdo shoqërie, ndërsa zhvillimi i qëndrueshëm është dhe do të mbetet kryeobjektivi i planeve dhe strategjive të çdo qeverie të përgjegjshme.

Bashkëjetesa midis shtetit ligjor të konsoliduar, jetës ekonomike të mirëstrukturuar dhe demokracisë funksionale të shtrirë në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore është padyshim garancia kryesore për realizimin e kësaj asprate.

Kjo bashkëjetesë duhet mbrojtur pa reshtur, me të njëjtën dashuri, vullnet dhe forcë që një prind i përgjegjshëm mbron fëmijën nga çdo rrezik që mund t'i kanoset mirëqenies së tij fizike apo psiko-emocionale.

Por që të mbrosh diçka, duhet fillimisht ta kesh atë. Në cilën fazë është Shqipëria sot: në fazën që i duhet të mbrojë atë që ka, apo në fazën e krijimit të asaj që parimisht do të duhet të mbrojë? Ngjason me një lojë fjalësh, por faktikisht është pyetje retorike. Përgjigja ime shkon padyshim për alternativën e dytë. Fatkeqësisht, vendi im nuk e gëzon sot bashkëjetesën e tre elementëve të lartpërmendur dhe kjo, sipas meje, vjen kryesisht për shkak të fenomenit të korrupsionit.

Arbeni, një student i dobët i degës “Matematikë” për shkak se paguan disa para nën dorë të një ose disa pedagogë, arrin të diplomohet dhe të punësohet si mësues në një shkollë të mesme. Pra, supozohet t'i japë konceptet e qarta të matematikës Oltit 15-vjeçar, që ëndërron të jetë një inxhinier i ardhshëm. Por tri vitet e gjimnazit ikin shpejt dhe, për shkak të shpjegimit aspak cilësor, Olti humb vetëbesimin në matematikë dhe mangësitë në këtë lëndë ia pamundësojnë atij ndjekjen e studimeve në një degë inxhinierie. Demoralizimi i djalit në fjalë është i pashmangshëm. Korrupsioni ia doli suksesshëm të thyejë ëndrrën e një të djali të ri. Fatkeqësisht kjo ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë në Shqipëri.

Nga ana tjetër, një qytetar që në përpjekje për të zgjidhur një problem të caktuar, has në çdo hap barrierat e ngritura padrejtësisht kundër tij nga gjyqtarë e zyrtarë të tjerë të korruptuar të sistemit të drejtësisë, padyshim që demoralizohet dhe humb shpresën të i ashtuquajtur “shtet ligjor” dhe, pse jo, përgatitet që në të ardhmen të fitojë të drejtat e tij nëpërmjet një arme që mesa duket qenka “trendy” dhe shumë efikase: korrupsionit. Korrupsioni sapo u injektua në qasjen e qytetarit në fjalë ndaj zgjidhjes së problemeve të tij, si mënyra e vetme për të fituar drejtësinë në një sistem drejtësie të padrejtë. Një qytetar më shumë u “infektua” me virusin e korrupsionit. Sa keq...

Padyshim që gama e fushave ku korrupsioni godet dhe dobëson bazamentet e shtetit ligjor, e jetës ekonomike dhe të demokracisë së brishtë të vendit tonë, është e gjerë: arsim, shëndetësi, politikë, sport etj., por pasoja më e rëndë që unë besoj se korrupsioni shkakton është pikërisht

demoralizimi dhe humbja e shpresës. Nuk ka për mendimin tim, faktor më pengues në përpjekjet e një shoqërie për të ecur përpara, sesa varfëria e shpresave.

Për shumë vite, në vendin tim vija ndarëse midis praktikave ligjore dhe atyre “ligjoro-korruptive” u bë thuajse e padukshme, por besoj që kohët e fundit, edhe në sajë të apeleve të vazhdueshme të faktorit ndërkombëtar, janë pjekur kushtet që si shoqëri, të ridimensionojmë qasjen tonë ndaj këtij fenomeni.

Unë jam sot 24 vjeç. Besoj që unë dhe të tjerë të rinj si unë, jemi ata që duhet të valëvitim flamurin e kësaj qasje të re. Është disi e vështirë të propozoj zgjidhje konkrete në nivel strategjik për një rritje të efikasitetit të luftës ndaj korrupsionit në fusha të ndryshme, por besoj që këtë ndryshim duhet ta fillojmë nga vetja.

Gjithsekush duhet të reflektojë dhe me veprimet e tij konkrete të refuzojë dhe të përbuzë pa mëdyshje dhe me forcë çdo praktikë korruptive. Dhe në rastet kur dikush ka dijeni për praktika të tilla, zgjidhja më e mirë padyshim do të ishte denoncimi në organet kompetente. Nevojiten jo lot e ngashërime kolektive për gjendjen aktuale dhe moralizma kuturu, por akte dhe veprime konkrete.

Unë do t’i bëj në universitet, në institucione e kudo sepse dua të jap mesazhin dhe te personat që më rrethojnë, që antivirtyti mund të luftohet dhe vlera mund të arrihet. Unë besoj te forca e shembullit.

Shoqëria që promovon vlerat e drejtësisë, konkurrueshmërisë së ideve dhe iniciativave të lira të njerëzve dhe pse jo... shoqëria që punon e gjitha si një trup i vetëm për një ekonomi e të ardhme më të mirë është shoqëria që unë dua.

Kjo është arsyeja pse unë si i ri, i them dhe gjithmonë do t’i them **JO KORRUPSIONIT!** Ashtu siç krimi pjell krim, korrupsioni pjell korrupsion e padrejtësi. Është një rreth vicioz, i cili duhet ndalur... **TANI!**

## Nga Arjeta Zenelaj

Fenomeni i korrupsionit është një nder me shqetësuesit te shoqërisë mbarë globale. Duke shfrytëzuar terrenin e një shoqërie te ashtuquajtur “demokratike”, ky virus e zhyt shoqërinë duke mos e lejuar te kapërceje ne trampolinat e zhvillimit human e demokratik.

Para se te analizoj ketë teme, e shoh te arsyeshme që të jap një përkufizim mbi korrupsionin, si pikënisje në trajtimin e problemit. Përkufizimi më gjerësisht i pranuar i korrupsionit është si “abuzim me detyrën për përfitime personale” (korrupsioni në kuptimin e gjerë). Ndërsa, në përpjekje për të gjetur një përkufizim më të ngushtë të korrupsionit mund ta përkufizojmë atë si “çdo shkelje të detyrës të personave zyrtarë ose personave përgjegjës të subjekteve juridike dhe çdo veprimtari e iniciatorëve apo përfituesve të kësaj sjelljeje, e drejtuar si përgjigje ndaj një shërbimi që drejtpërdrejtë ose indirekt është premtuar, ofruar, kërkuar, pranuar apo është pritur për t’u marrë për veten apo për një person tjetër”. Veçanërisht ky fenomen ne një vend i cili është akoma ne tranzicion, krahas pengesave ne zhvillimin ekonomik e politik, po ndikon ne mos-zhvillimin e emancipimit social. Është e rëndësishme të kuptuarit mirë të këtij definicioni, sepse në shumë raste mund të anashkalohet kuptimi i tij i vërtetë, duke u deformuar e duke marrë trajta të tjera, kjo për arsye se ka një prirje nga ana e publikut shqiptar që të përfshijë në konceptin e “korrupsionit” edhe dukuri të cilat nuk janë të tilla. Për të analizuar sjelljen e shoqërisë karshi këtij problem duhen pasur parasysh disa situata, të cilat çojnë në një tjetër tezë: “Sa te varur jemi ne nga korrupsioni”? Kjo nënkupton se shpeshherë ne jemi viktimat apo inicializuesit e tij? Duke u bazuar ne një sondazh te vitit 2009<sup>1</sup>, kur gjykojnë të dy palët e përfshira në një transaksion korruptiv, shqiptarët tregohen më tolerantë kundrejt “dhënësve” të ryshfetit dhe më të ashpër kundrejt “marrësve”. Një nxënës i cili i jep një dhuratë mësuesit të tij me shpresën se do të marrë një notë më të mirë është vlerësuar ose i pa korruptuar (35.4%) ose i justifikuar (34.7%). Gjithashtu dhe një nënë e cila paguan 500 lekë për të shmangur radhën për marrjen e një certifikate për fëmijët e saj shihet si jo e korruptuar (26.3%) ose gjerësisht e justifikuar (43.4%). Këto statistika të çojnë në një përfundim jo të kënaqshëm, që një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë, në mënyrë të vetëdijshme apo jo, janë pro korrupsionit. Pjesa dërrmuese, që janë viktimat të korrupsionit, qëndrojnë indiferentë, duke refuzuar t’i japin zgjidhje këtij problemi të vjetër sa vetë njerëzimi. Arsyeja kryesore që ky fenomen ka ekzistuar dhe është akoma i pranishëm në shoqëri është se shkaqet që çojnë në zhvillimin e këtij fenomeni nuk kanë arritur të eliminohen tërësisht, pavarësisht zhvillimeve që kanë ndodhur me kalimin e kohës. Papunësia është e lartë, kurse shteti tenton të zvogëlojë papunësinë duke hapur vende të reja pune në sektorët e shërbimeve/sectorët publikë;

Të punësuarit kanë paga të vogla dhe shumica e tyre mund të konsiderohen se jetojnë nën ose në kufirin e varfërisë;

Shoqëria civile dhe mediat janë të pazhvilluara ose të dobëta, mungesa e transparencës nga ana e institucioneve apo qeverisë, dhe shumë shkaqe të tjera të cilat sigurojnë vazhdimin e këtij fenomeni. Kjo analizë na sjell në konkluzion se nuk duhet të presim që ky fenomen të zhduket nga qeveritë me platformat e tyre elektorale apo politike, por rezultati mund të arrihet nga një

---

<sup>1</sup> Sondazh mbi korrupsionin (2009) <http://www.idra-al.org/cs2009/Korrupsioni%20ne%20Shqiperi%202009%20-%20Permbledhje%20e%20rezultateve.pdf>

transaksion i ndërsjellë ndërmjet qeverisë dhe popullit, madje rolin më të madh e kanë vetë qytetarët, duke zbatuar me përpikëri detyrimet e tyre, ligjin dhe kërkesën deri në fund për plotësimin e të drejtat të tyre në rast shkeljeje. Hapi i parë për krijimin një shoqërie të shëndetshme është rritja e shkallës së ndërgjegjësimit kolektiv mbi shkaqet si dhe pasojat e korrupsionit në shoqëri. Gjithashtu, është e paevitueshme ndihma e qeverisë në ndikimin e uljes së nivelit të korrupsionit, kjo duke rritur transparencën me qytetarët, ndëshkimin me ligj të iniciatorëve të korrupsionit, arritjen e një stabiliteti ekonomik. Pra, hallka kryesore për reduktimin e këtij fenomeni është zbatueshmëria me përpikëri e legjislacionit nga ana e gjithsecilit. Kjo do të ndikojë, gjithashtu, në rritjen e shkallës së integriteti ekonomik, politik e social të vendit tonë, në rajon e më gjerë.

Prandaj indiferenca nuk është përgjigje! Detyra jonë si individë është të ndihmojmë në prosperitetin e vendit tonë, arritjen e një stadi më të lartë të mirëqenies dhe sigurimin e një të ardhmeje me të shëndetshme për ne brezat pasardhës. Për ta përmbyllur, preferoj të theksoj një citat të shkrimtarit e filozofit Ukshin Hoti: “SHQIPERINË E PABËRË, BËJE SHQIPËRI TË BËRË, BËJE OSE VDIS...!”

## Nga Ketu Gjipali

Mendimi i parë që na vjen në mendje për korrupsionin është që njerëzit nuk e njohin të gjithë gamën e tij. Shpesh herë e bëjnë pa vetëdije. Në fakt, sipas studiueses Suzana Jašić (2015)<sup>2</sup>, korrupsioni nuk ka një përkufizim që të pranohet nga të gjithë. Pikërisht një mungesë e tillë e bën të vështirë përcimin e kuptimit të korrupsionit nga një entitet në një tjetër.

Korrupsioni është dëmtim ekonomik i interesit publik për përfitim personal. Kjo gjë sjell një dëmtim të gjithanshëm të sistemit politik e ligjor të një vendi. Jašić thotë se "shkëmbimi që rezulton nga korrupsioni çon në dështim të interesit publik, dëmtim ekonomik dhe prishje të besimit publik në institucionet shtetërore". Detyra jonë, në këtë çast, është të flasim vetëm për korrupsionin, por efektet e tij përforcohen edhe nga të tjera aktivitete, të cilat mund të jenë nga më të padukshmet si shfrytëzimi i konfliktit të interesit e deri tek kapja e shtetit.

Ndikimet e korrupsionit janë të prekshme të paktën çdo ditë të cilitdo individ. Vetë pjesëmarrja në një konkurs eseje me këtë temë nis me dyshim. Dyshimi bën që edhe nëse vlerësimi final do të ishte i drejtë, fjalët do të përhapeshin me pakënaqësi dhe ne si marketerë e dimë që një individ i pakënaqur i thotë të paktën dhe dhjetë vetave të tjerë, ndërsa kënaqësia ndahet vetëm me 3 persona të tjerë. Megjithatë nuk duam të themi se ndryshimi nuk po ndjehet, por cilat janë pasojat e jetesës për kaq kohë "në të zezë"? Brerja e ndërgjegjes kur nuk e dorovit mjekun, jo se ai ta kërkoi, ai u soll shumë mirë, por zakoni është vështirë të hiqet dhe lë shenjë.

Megjithatë zakonet e vjetra zëvendësohen me të reja dhe procesi ka filluar. Shpesh herë rregullatorët e parë që sugjerohen janë ligje e rregulla, por ligjet përdorin forcën, ndërsa planet e veprimt ndërgjegjësimit. Ndoshta në këtë pikë ku kemi mbërritur ndërgjegjësimi s'mund të t'ia dalë i vetëm, por dhe forca është një strategji dritë shkurtër. E rëndësishme është edukimi dhe induktimi i kulturës anti-korrupsion që në fëmijëri, që në librin e parë të "Edukatës Qytetare". Nuk duhet harruar që vetë prindërit mësojnë shumë gjëra nga fëmijët e tyre.

Prandaj konkluzioni për mjetet që e luftojnë këtë fenomen janë të gjitha sa përmendëm më sipër, edhe forca edhe ndërgjegjësimi. Të dyja mjetet se bashku, krijojnë sinergjinë e duhur, në mënyrë që qytetarët të bëjnë tyrin mendimin që korrupsion është dhe blerja e një mjekimi në vendin që të sugjeroi ekskluzivisht mjeku ku u vizitove. Po, një gjë e tillë hap mundësitë për konkurrence të pandershme në treg duke shfrytëzuar konfliktin e interesit.

Së fundi, ekuacioni i përgjithshëm i korrupsionit është të qenit monopol në vendimmarrje, duke i shtuar lirinë e veprimt dhe duke hequr transparencën. Kohët e fundit, me zgjerimin e mundësive të komunikimit dhe kontributin e madh të rrjeteve sociale, transparenca po shtohet në të dy anët e barazimit me doza të vogla. Kjo gjë po e zhvlerëson ekuacionin gradualisht, duke vendosur një barazim të ri. Barazimi i ri do të jetë ai që do të ketë një normë të pranueshme mungese transparence, me limitin që shkon drejt zeros.

---

<sup>2</sup> Jašić, Suzana, Leksion mbi Qeverisjen e Mirë, tetor 2015